

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E GJELBËRIMIT DEKORATIV

Nr. _____ prot.

Tiranë më , ____ . ____ . 2026

DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:
“NDËRTIMI I HAPËSIRAVE REKREATIVE NË PMLAT”

1-“PASQYRA E DIJES”

2-“YOGA NË NATYRË”

3-“PARK AVENTURASH ”

Tiranë, Prill 2026

1-“PASQYRA E DIJES”

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit kërkon të realizojë projektin e zbatimit për studim-projektimin për objektin : “Pasqyra e Dijes”, Parku i madh i Liqenit Artificial, Njësia Administrative Nr.5 në qytetin e Tiranës.

1.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EGZISTUESE E OBJEKTIT

Vendndodhja: Në pjesën jugore të qytetit të Tiranës, Parku i madh i Liqenit Artificial, Njësia Administrative Nr.5.

Përshkrim: Parku i madh i Liqenit Artificial (PMLAT) daton prej vitit 1957-1958. Sipërfaqja e PMLAT përbëhet nga një masiv kodrinor me shpate me pjerrësi të vogël. Në pjesën jugore formohet pasqyra ujore e Liqenit Artificial. Sipërfaqja aktuale e Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës është 1 569 337 m², ndërsa ajo e Liqenit Artificial është 450 000 m². PMLAT përbën masivin më të madh të gjelbërimit në qytetin e Tiranës, që ndikon në krijimin e peisazhit dhe të mikroklimës së zonës.

Hapësira e propozuar për “Pasqyrën e dijes” ndodhet në afërsi të hyrjes kryesore të PMLAT, në një distancë rreth 450 m linear prej saj, buzë pedonale kryesore, duke e bërë këtë zonë mjaft të përshtatshme për akses maksimal nga çdo kategori. Zona ka një pozicion mjaft të favorshëm duke qënë se ndodhet në një reliev të sheshtë dhe në kryqëzimin e katër pedonaleve.



Ortofoto të gjendjes ekzistuese



Ortofoto të gjendjes ekzistuese



Foto të gjendjes ekzistuese



Foto të gjendjes ekzistuese (Akseset kryesore)

2. KËRKESA PROJEKTIMI TË PËRGJITHSHME PËR PROJEKTIMIN E HAPËSIRËS SË PASQYRËS SË DIJES.

Realizimi i strukturës “Pasqyra e Dijes” synon të pasurojë jetën kulturore dhe sociale të qytetit, duke krijuar një hapësirë publike inovative, edukative dhe të qëndrueshme, në një nga zonat më të frekuentuara rekreative të Tiranës.

Projekti synon krijimin e një hapësire publike multifunksionale, e cila do t’u shërbejë vizitorëve të parkut si një pikë edukimi, reflektimi dhe ndërveprimi kulturor, në harmoni të plotë me mjedisin natyror përreth.

“Pasqyra e Dijes” është një objekt leximi, i hapur dhe i aksesueshëm, që promovon dijen, kulturën dhe përdorimin cilësor të hapësirës publike, i konceptuar si një objekt i lehtë, bashkëkohor dhe transparent, i cili reflekton si në kuptimin fizik ashtu edhe simbolik lidhjen mes dijes, natyrës dhe komunitetit.

Objektivat specifike të projektit janë:

- Krijimi i një hapësire që nxit leximin dhe edukimin;
- Integrimi i strukturës në peizazhin natyror të Liqenit Artificial;
- Ofrimi i një ambienti të qetë, tërheqës dhe funksional për përdorues të të gjitha moshave;
- Nxitja e aktiviteteve kulturore dhe sociale në hapësirë publike.

Struktura do të shërbejë si:

- Hapësirë leximi individuale dhe kolektive;
- Pikë pushimi dhe reflektimi për vizitorët;
- Element orientues dhe identitar në territorin e parkut.

Forma, materialet dhe organizimi hapësinor do të jenë objekt propozimi nga subjektet projektuese, duke respektuar parimet e qëndrueshmërisë dhe kontekstin natyror.

Karakteristika teknike të përgjithshme të strukturës:

- Struktura të jetë e tipit të lehtë, me ndërhyrje minimale në terren dhe pa dëmtuar gjelbërimin ekzistues;
- Zgjidhja konstruktive të garantojë stabilitet, siguri dhe jetëgjatësi, në përputhje me normat teknike në fuqi;
- Të parashikohet rezistencë ndaj kushteve atmosferike (lagështirë, rrezatim diellor, erë, reshje).

Materiale ndërtimi:

- Përdorimi i materialeve të qëndrueshme, ekologjike dhe të riciklueshme, të përshtatshme për ambiente të jashtme;
- Preferohet përdorimi i:
 - Strukturave metalike të lehta ose druri të trajtuar;
 - Xhamit të sigurisë ose materialeve transparente/përgjysmë transparente;
 - Elementeve që kërkojnë mirëmbajtje të ulët.
- Materialet të jenë rezistente ndaj konsumimit dhe vandalizmit.

Organizimi funksional:

- Hapësirë leximi të mbrojtur nga dielli dhe reshjet;
- Mundësi për lexim individual dhe përdorim kolektiv;
- Integrim i mobilimit urban (ulëse, tavolina leximi, rafte librash);
- Organizim fleksibël që lejon përdorime të ndryshme gjatë ditës;
- Video-projektor për zhvillimin e aktiviteteve që lidhen me leximin.

Ndriçimi

- Shfrytëzim maksimal i ndriçimit natyror;
- Ndriçim artificial diskret, me konsum të ulët energjie (preferohet LED);
- Ndriçimi të garantojë siguri dhe komoditet gjatë orëve të mbrëmjes;
- Panele diellore.

Aksesueshmëria


- Akses i garantuar për persona me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet përkatëse;
- Qartësi orientimi dhe përdorimi për të gjithë vizitorët.

Aspektet mjedisore

- Ndërhyrje minimale në terren dhe respektim i peizazhit natyror;
- Parashikim i zgjidhjeve që reduktojnë ndikimin mjedisor;
- Mundësi për përdorimin e energjive alternative (p.sh. panele diellore) si opsion projektues;
- Kosha të diferencuar për mbetjet;
- Vending machine.

Siguria dhe mirëmbajtja

- Projektimi të sigurojë përdorim të sigurt për të gjitha grupmoshat;
- Elemente konstruktive dhe materiale që lejojnë mirëmbajtje të thjeshtë dhe ekonomike;
- Zgjidhje që minimizojnë rrezikun e dëmtimeve dhe aksidenteve;
- Inkorporimi i sistemit të kamerave dhe internetit.



3. REKOMANDIME

Projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit përpara fillimit të punës për projektimin, ashtu si edhe gjatë fazave të projektimit të tij me qëllim garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

4. FAZAT E REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Fazat e projektimit për këtë objekt referuar *Vkm-së nr.354, datë 11.05.2016, Seksioni I, Neni 25* janë:

- Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit;
- Projektideja paraprake;
- Projektideja përfundimtare;
- Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit;
- Projekti i zbatimit;
- Preventivi përfundimtar;
- Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi;

A. ANALIZA E DETYRËS SË PROJEKTIMIT DHE PËRCAKTIMI I BAZËS SË PROJEKTIT.

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/ termave të referencës;
- Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;
- Formulimi i kërkesave për zgjidhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;

- Përmbledhja e rezultateve;

B. PROJEKT-IDEJA PARAPRAKE (PËRGATITJA E PROJEKTIT DHE ECURISË PROJEKTUESE)

- Analiza e bazës materiale dhe e parimeve;
- Dakordësimi mbi objektivat (kushtet përreth objektivit, konfliktet eventuale për arritjen e objektivit);
- Përgatitja e një katalogu/liste të planeve që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);
- Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundur;
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistët e pjesëmarrjes në projekt;
- Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektivit në planin e qytetit, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionale, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjitik dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjikë, proceset dhe kushtet, si dhe në barrën imponuese, ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmëritë e tyre;
- Negociatat paraprake me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e mundësisë së marrjes së lejes së ndërtimit të objektivit;
- Në projektimin e ambjenteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elementët (si psh. toka, uji, klima, ajri, flora dhe fauna), plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese veçanërisht në lidhje me peisazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojërave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimi me objektet rrethuese;
- Parashikimi i kostove;
- Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit;

C. PROJEKT-IDEJA PËRFUNDIMTARE (SISTEMET DHE PLANIFIKIMI I INTEGRUAR)

- Përpunimi i konceptit të projektit (përpunimi hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, eficientësi financiare dhe energjitike dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projekt-idesë përfundimtare;
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt;

- Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi;
- Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit psh: projekt-idesë paraprake dhe/ose projekt-idesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës. Për sipërfaqet e hapura paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmerren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit. Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të mureve ndarëse, ngjyra, drita dhe materialet, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapësinore.
- Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt;
- Parashikimi i kostove sipas manualit të çmimeve, të miratuar me akte nënligjore që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit;
- Kontrolli i kostove duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake;
- Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit;

D. PROJEKTI PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT

- Përgatitja e dokumentave të dorëzimit për miratim dhe lejet e kërkuara, në bazë të rregullores për planifikimin urban, duke përfshirë edhe kërkesat për përjashtime dhe ngrirje/shtyrje kushtesh, duke përdorur ndihmesën e ofruar nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt si dhe ndonjë negociim me autoritetet publike;
- Dorëzimi i dokumentave në Entin Publik;
- Përfundimi dhe plotësimi nëse është i nevojshëm i kërkesës së projektit, përshkrimet dhe shpenzimet duke përdorur ndihmesën e specialistëve të përfshirë në projekt;
- Sistemimet e jashtme dhe punimet e ndërtimit: Kontrollimi i kërkesave dhe lejeve të veçanta që duhen për miratimin e kërkesës dhe për marrjen e lejes së ndërtimit;

E. PROJEKTI I ZBATIMIT

- Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke pasur parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi të zbatueshëm);
- Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim psh. zbatimin i plotë e përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri në 1:1, për strukturat në ambjentet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri në 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacion përkatës;

- Për ndërtesa: paraqitja e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve;
- Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit;
- Azhornimi i vazhdueshëm i projektit zbatues gjatë fazës së zbatimit;

F. PREVENTIVI PËRFUNDIMTAR

- Përcaktimi dhe mbledhja e masave për të prodhuar specifikimet e projektit duke përdorur kontributet e dhëna nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt;
- Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës;
- Harmonizimi dhe koordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistët e përfshirë në planifikimin e projektit;

G. PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT PËR PROCEDURË TENDERIMI

- Përmbledhja e dokumentave për të gjitha fushat e punës;
- Verifikimi dhe vlerësimi i termave të referencës përfshirë hartimin e dokumentacionit për prokurim;
- Akordimi dhe përmbledhja e punimeve të atyre që marrin pjesë profesionalisht, të cilët bashkëpunojnë gjatë dhënies së dokumentave;
- Llogaritja e shpenzimeve;
- Bashkëveprim gjatë dhënies së ofertës;

2-“YOGA NË NATYRË”

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit kërkon të realizojë projektin e zbatimit për studim-projektimin për objektin :“Yoga në natyrë”, Parku i madh i Liqenit Artificial, Njësia Administrative Nr.5 në qytetin e Tiranës.

1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT

Vendndodhja: Në pjesën jugore të qytetit të Tiranës, Parku i madh i Liqenit Artificial, Njësia Administrative Nr.5.

Përshkrim: Parku i madh i Liqenit Artificial (PMLAT) daton prej vitit 1957-1958. Sipërfaqja e PMLAT përbëhet nga një masiv kodrinor me shpate me pjerrësi të vogël. Në pjesën jugore formohet pasqyra ujore e Liqenit Artificial. Sipërfaqja aktuale e Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës është 1 569 337 m², ndërsa ajo e Liqenit Artificial është 450 000 m². PMLAT përbën masivin më të madh të gjelbërimit në qytetin e Tiranës, që ndikon në krijimin e peizazhit dhe të mikroklimës së zonës.

Hapësira e Yogës do të pozicionohet në një zonë strategjike brenda Parkut të Madh të Liqenit Artificial, pranë zonës së hyrjes kryesore të liqenit. Largësia e zonës së marrë në studim nga qendra e qytetit të Tiranës është afërsisht rreth 1.2 km linear, dhe 670 m linear nga hyrja kryesore e liqenit.

Kjo zonë përfiton nga afërsia me rrugët kryesore të parkut, duke ofruar qasje të lehtë për vizitorët. Zona është e rrethuar nga gjelbërim natyror duke krijuar një mjedis të qetë dhe të sigurt për zhvillimin e këtij aktiviteti. Gjithashtu kjo zonë ndodhet në afërsi të tualeteve dhe çezmës për freskim.



Foto të gjendjes ekzistuese:





2. KËRKESA PROJEKTIMI TË PËRGJITHSHME PËR PROJEKTIMIN E HAPËSIRËS SË YOGËS NË NATYRË.

Yoga në natyrë është një praktikë e Yogës që zhvillohet në mjedise të hapura si parqe, male, plazhe apo kopshte, duke shfrytëzuar kontaktin e drejtpërdrejtë me natyrën për të thelluar përvojën fizike, mendore dhe shpirtërore të praktikuesit. Yoga në natyrë mund të zhvillohet individualisht apo në grupe të organizuara, shpesh në mëngjes ose në orët e perëndimit të diellit, kur klima është më e përshtatshme. Zakonisht zhvillohet në parqe urbane.

Krijimi i një **hapësire të dedikuar për yoga në një park urban** nuk është thjesht një investim në mirëqenien fizike, por edhe një **ndërhyrje me ndikim të gjerë urban dhe social**. Integrimi i një ndërhyrjeje të tillë në PMLAT sjell benefitet e mëposhtme:

- Kontribuon në kthimin e parkut në një qendër multifunktionale, e cila rrit cilësinë e jetesës për banorët;

- Ofron një alternativë të lirë, të hapur dhe më pak të varur nga struktura fizike për aktivitet fizik dhe relaksim;
- Reflekton tendencat moderne të qyteteve të gjelbërta dhe të qëndrueshme;
- Hapësira është gjithëpërfshirëse, pa kufizime moshe apo gjinie, dhe shërben si një pikë takimi për individë me interesa të përbashkëta;
- Nxiti ndërveprimin social, bashkëpunimin dhe lidhjet mes banorëve të zones;
- Krijohet një mjedis ku njerëzit frymëzohen të bëjnë zgjedhje më të mira për shëndetin mendor dhe fizik;
- Reduktim i stresit urban në komunitet;
- Mundësi për organizimin e **eventeve komunitare, punëtorive ose klasave edukuese në natyrë**;

Krijimi i një hapësire yoga në natyrë, të përshtatshme për 40-50 persona brenda parkut të liqenit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) Sipërfaqja e nevojshme për person për yoga është 2 m². Për kapacitetin që ne kërkojmë të mbulojmë prej 50 personash maksimum rekomandohet një sipërfaqe 150-200 m² në tokë të barabartë ose të niveluar duke siguruar lëvizshmërinë dhe distancën e sigurisë.
- b) Hapësira e yogës duhet të ketë:
 - Ndriçim për aktivitete në mëngjes herët ose në mbrëmje;
 - Sinjalistikë minimale për orientim;
 - Larg rrugëve apo aktiviteteve të zhurmshme;
 - Në afërsi të banjove publike (rekomandohet <150 m);
 - Pikë uji të afërt;
 - Stola për pushim dhe qëndrim;
 - Hijëzim;
- c) Duke qënë se përdorimi i hapësirës së yogës do të jetë i përhershëm dhe jo sezonal elementët konstruktive që nevojiten janë:
 - Platformë mbi tokë me konstruksion druri me trajtim antirreshkitës;
 - Rrethim i pjesshëm me kontur të ulët për ndarje vizuale;
 - Sistem i thjeshtë drenazhi për të shmangur grumbullimin e ujit;
 - Elemente dekorative (gurë dekorative);
 - Kosha të diferencuar për depozitimin e mbetjeve;
 - Pika karikimi të inkorporuara me platformën;
 - Tendë në lartësi 4m.



3. REKOMANDIME

Projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit përpara fillimit të punës për projektimin, ashtu si edhe gjatë fazave të projektimit dhe zbatimit të tij me qëllim garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

4. FAZAT E REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Fazat e projektimit për këtë objekt referuar *Vkm-së nr.354, datë 11.05.2016, Seksioni II, Neni 31* janë:

- Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit;
- Projektideja paraprake;
- Projektideja përfundimtare;
- Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit;
- Projekti i zbatimit;
- Preventivi përfundimtar;
- Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi;

A. ANALIZA E DETYRËS SË PROJEKTIMIT DHE PËRCAKTIMI I BAZËS SË PROJEKTIT.

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/ termave të referencës;
- Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;
- Formulimi i kërkesave për zgjidhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;
- Përmbledhja e rezultateve;

B. PROJEKT-IDEJA PARAPRAKE (PËRGATITJA E PROJEKTIT DHE ECURISË PROJEKTUESE)

- Analiza e bazës materiale dhe e parimeve;
- Dakordësimi mbi objektivat (kushtet përreth objektivit, konfliktet eventuale për arritjen e objektivit);
- Përgatitja e një katalogu/listë të planeve që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);
- Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundur;
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistët e pjesëmarrjes në projekt;
- Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektit në planin e qytetit, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionale, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjistik dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjikë, proceset dhe kushtet, si dhe në barrën imponuese, ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmëritë e tyre;
- Negociatat paraprake me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e mundësisë së marrjes së lejes së ndërtimit;
- Në projektimin e ambjenteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elementët (si psh. toka, uji, klima, ajri,

flora dhe fauna), plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese veçanërisht në lidhje me peisazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojërave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimi me objektet rrethuese;

- Parashikimi i kostove;
- Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit;

C. PROJEKT-IDEJA PËRFUNDIMTARE (SISTEMET DHE PLANIFIKIMI I INTEGRUAR)

- Përpunimi i konceptit të projektit (përpunimi hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimin e projekt-idesë përfundimtare;
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt;
- Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi;
- Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit psh: projekt-idesë paraprake dhe/ose projekt-idesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës. Për sipërfaqet e hapura paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmerren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit.
- Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt;
- Parashikimi i kostove sipas manualit të çmimeve, të miratuar me akte nënligjore që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit;
- Kontrolli i kostove duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake;
- Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit;

D. PROJEKTI PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT

- Përgatitja e dokumentave të dorëzimit për miratim dhe lejet e kërkuara, në bazë të rregullores për planifikimin urban, duke përfshirë edhe kërkesat për përjashtime dhe ngrirje/shtyrje kushtesh, duke përdorur ndihmesën e ofruar nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt si dhe ndonjë negociim me autoritetet publike;
- Dorëzimi i dokumentave në Entin Publik;

- Përfundimi dhe plotësimi nëse është i nevojshëm i kërkesës së projektit, përshkrimet dhe shpenzimet duke përdorur ndihmesën e specialistëve të përfshirë në projekt;
- Sistemimet e jashtme dhe punimet e ndërtimit: Kontrollimi i kërkesave dhe lejeve të veçanta që duhen për miratimin e kërkesës dhe për marrjen e lejes së ndërtimit;

E. PROJEKTI I ZBATIMIT

- Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke pasur parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi të zbatueshëm);
- Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim psh. zbatimi i plotë e përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri në 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri në 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqeruar me relacion përkatës;
- Përgatitja e bazës, për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit;
- Azhurnimi i vazhdueshëm i projektit zbatues gjatë fazës së zbatimit;

F. PREVENTIVI PËRFUNDIMTAR

- Përcaktimi dhe mbledhja e masave për të prodhuar specifikimet e projektit duke përdorur kontributet e dhëna nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt;
- Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës;
- Harmonizimi dhe koordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga specialistët e përfshirë në planifikimin e projektit;

G. PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT PËR PROCEDURË TENDERIMI

- Përmbledhja e dokumentave për të gjitha fushat e punës;
- Verifikimi dhe vlerësimi i termave të referencës të përfshirë hartimin e dokumentacionit për tenderim;
- Akordimi dhe përmbledhja e punimeve të atyre që marrin pjesë profesionalisht, të cilët bashkëpunojnë gjatë dhënies së dokumentave;
- Llogaritja e shpenzimeve;
- Bashkëveprim gjatë dhënies së ofertës;

3-“PARK AVENTURASH ”

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionitkërkon të realizojë projektin e zbatimit për studim-projektimin për objektin : “Park aventurash”, Parku i madh i Liqenit Artificial, Njësia Administrative Nr.5 në qytetin e Tiranës.

1.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME DHE GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT

Vendndodhja: Në pjesën jugore të qytetit të Tiranës, Parku i madh i Liqenit Artificial, Njësia Administrative Nr.5.

Përshkrim: Parku i madh i Liqenit Artificial (PMLAT) daton prej vitit 1957-1958. Sipërfaqja e PMLAT përbëhet nga një masiv kodrinor me shpate me pjerrësi të vogël. Në pjesën jugore formohet pasqyra ujore e Liqenit Artificial. Sipërfaqja aktuale e Parkut të Madh të Liqenit Artificial të Tiranës është 1 569 337 m², ndërsa ajo e Liqenit Artificial është 450 000 m². PMLAT përbën masivin më të madh të gjelbërimit në qytetin e Tiranës, që ndikon në krijimin e peisazhit dhe të mikroklimës së zonës.

Hapësira e propozuar për “Park aventurash” ndodhet në pjesën jug-lindore të PMLAT, në afërsi të shkollës “Uilson” 1.8 km nga hyrja kryesore e liqenit . Zona kufizohet në pjesën veriore nga pedonalja kryesore ne distancë 120 m në vijë ajrore dhe në pjesën jugore nga pista e biçikletave. Kjo hapësirë është e favorshme për shkak të bimësisë së lartë dhe të qëndrueshme (10-15 vjeçare). Gjithashtu kjo zonë rrethohet nga pemë të dendura dhe peisazh natyror, çka krijon një ambient ideal për një park aventurash me elemente në ajër (linja zip-line, staza këmbësore, etj.). Pemët e larta dhe relievi natyror ofrojnë një kornizë natyrore perfekte për sporte dhe aktivitete rekreative në natyrë.



Ortofoto të gjendjes ekzistuese



Ortofoto të gjendjes ekzistuese





Foto të gjendjes ekzistuese (Akseset kryesore)



Foto të gjendjes ekzistuese

2. KËRKESA PROJEKTIMI TË PËRGJITHSHME PËR PROJEKTIMIN E HAPËSIRËS “PARK AVENTURASH”.

Projektimi i hapësirës për “Park Aventurash” duhet të realizohet në përputhje me kriteret funksionale, teknike, mjedisore dhe të sigurisë, duke garantuar përdorim të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të territorit të planifikuar. Zgjidhjet projektuese duhet të reflektojnë karakterin rekreativ dhe aventuror të objektit, si dhe të jenë në harmoni me kontekstin urban dhe natyror. Kontribuon në kthimin e parkut në një qendër multifunkionale, e cila rrit cilësinë e jetesës për banorët. Integrimi i një ndërhyrjeje të tillë në PMLAT sjell benefitet e mëposhtme:

- Zhvillimin e hapësirave rekreative publike, duke krijuar një ambient të dedikuar për aktivitete fizike, argëtim dhe relaksim për grupe të ndryshme moshore.
- Promovimi i një stili jetese aktive dhe të shëndetshme, përmes aktiviteteve sportive dhe aventurore në natyrë.
- Rritja e ndërveprimit social dhe komunitar, duke ofruar hapësira që nxisin bashkëpunimin, lojën në grup dhe integrimin shoqëror.
- Përdorimi funksional dhe i qëndrueshëm i territorit, duke vënë në funksion zona të pashfrytëzuara ose me potencial zhvillimi.
- Ndikim pozitiv ekonomik dhe turistik, përmes tërheqjes së vizitorëve, krijimit të vendeve të punës dhe gjallërimit të aktivitetit lokal.
- Edukimi mjedisor dhe ndërgjegjësimi ekologjik, duke nxitur respektin ndaj natyrës dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore.
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës, duke kontribuar në mirëqenien fizike dhe psikologjike të përdoruesve.
- Krijimi i një identiteti të ri urban/territorial, që rrit vlerën estetike dhe funksionale të zonës përreth.

Organizimi funksional i hapësirës

Hapësira duhet të strukturohet në zona funksionale të qarta, të ndara sipas llojit të aktivitetit dhe intensitetit të përdorimit, me një sipërfaqe 2500-3000 m², me zonim si më poshtë:

- zona e aktiviteteve aventurore dhe sportive,
- zona e pritjes dhe orientimit,
- zona e pushimit dhe rekreacionit pasiv,
- hapësirat ndihmëse dhe shërbimet teknike.

Pajisje për aktivitete

- Projektimi i një **strukture me elemente në lartësi (High Ropes Course) me katër nivele vështirësie**, i cili përfshin struktura mbajtëse metalike/druri, platforma, elemente balancimi,

litarë sigurie dhe sistem të certifikuar sigurimi për përdoruesit. Projekti duhet të plotësojë standardet e sigurisë për parqet aventurash dhe normativat përkatëse për struktura rekreative në natyrë.

- Projektimi i linjave rrëshqitëse ajrore me kablo (Zip Line), të pajisura me platforma nisjeje dhe mbërritjeje, sistem ankorimi, tensionimi, sigurie dhe frenimit, në përputhje me standardet për struktura rekreative në lartësi.
- Projektimi i një **zone aventurash për fëmijë (Kids Trail)**, e përbërë nga pistë me pengesa në lartësi të ulët, e destinuar për grupmosha 4–12 vjeç (të shoqëruar nga prindërit), me elemente balancimi, ura litarësh dhe rrjeta sigurie, në përputhje me standardet e sigurisë për struktura rekreative për fëmijë të cilat konsistojnë në:
 - Lartësi më të ulët nga toka;
 - Pengesa më të lehta;
 - Platforma më të vogla;
 - Sisteme sigurie të përshtatura për fëmijë.
- Projektimi i një kulle kërcimi të lirë të kontrolluar (Free Jump / Quick Jump), të pajisur me sistem automatik frenimi dhe sigurimi, e destinuar për aktivitete rekreative në park aventurash e cila përfshin:
 - Platformën e kërcimit;
 - Sistem ankorimi;
 - Pajisjen automatike të frenimit (auto-belay);
 - Llogaritjen e ngarkesave dinamike;
 - Masat e sigurisë dhe zonën e impaktit;
- Projektimi i një **muri ngjitjeje artificial**, me nivele të ndryshme vështirësie, i pajisur me elemente sigurie (karabinera, rripa dhe pikat ankoruese).
- Sinjalistikë dhe informim:

Projekti duhet të parashikojë vendosjen e një sistemi të integruar sinjalistike dhe informimi, i cili përfshin tabela orientuese, sinjalistikë sigurie dhe elemente informuese për menaxhimin e emergjencave. Sinjalistika do të jetë e dukshme, rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe në përputhje me standardet grafike dhe të sigurisë në fuqi.
- Magazinë dhe mirëmbajtje:
 - Ruajtjen e pajisjeve të sigurisë;
 - Depozitimin e pajisjeve sezonale;
 - Ruajtjen e veglave të mirëmbajtjes;
 - Administrimin e inventarit;
 - Zona e ndihmës së shpejtë;
 - Nyje higjienosanitare.

Siguria dhe normat teknike

Të gjitha elementet e projektit duhet të përmbushin standardet në fuqi për sigurinë e përdoruesve. Pajisjet, strukturat mbajtëse dhe materialet e përdorura duhet të jenë të certifikuara dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit intensiv. Duhet të parashikohen:

- distanca sigurie ndërmjet aktiviteteve;
- sisteme mbrojtëse dhe sinjalistikë orientuese;
- akses për ndërhyrje emergjente dhe menaxhim të rrezikut;
- sistemi i monitorimit nëpërmjet vendosjes së kamerave.

- material i sigurtë (ashkla druri, tapet gome etj) në pjesën e zonës poshtë lodrave për sigurinë e përdoruesve.

Integrimi me mjedisin dhe konteksti

Projektimi duhet të respektojë karakteristikat natyrore dhe topografike të territorit, duke minimizuar ndërhyrjet artificiale. Ruajtja e gjelbërimit ekzistues dhe përshtatja e strukturave me terrenin përbëjnë kritere themelore. Zgjidhjet duhet të synojnë integrim vizual dhe funksional me mjedisin përreth.

Qëndrueshmëria dhe aspektet ekologjike

Projekti duhet të bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke promovuar përdorimin e materialeve ekologjike, dhe menaxhimin racional të burimeve natyrore. Duhet të merren në konsideratë zgjidhje për drenazh natyror, riciklim dhe reduktim të ndotjes mjedisore.

Aksesueshmëria dhe përfshirja

Hapësira duhet të projektohet në mënyrë që të jetë e aksesueshme për të gjithë përdoruesit, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Duhet të parashikohen shtigje të përshtatshme, pjerrësi të kontrolluara, elemente orientuese dhe zona të sigurta për përdorim gjithëpërfshirës.

Identiteti arkitektonik

Zgjidhjet arkitektonike dhe peisazhistike duhet të krijojnë një identitet të qartë vizual për Parkun e Aventurave, duke reflektuar karakterin dinamik dhe rekreativ të objektit. Estetika duhet të jetë në përputhje me funksionin, mjedisin dhe kërkesat teknike të projektit.

3. REKOMANDIME

Projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit përpara fillimit të punës për projektimin, ashtu si edhe gjatë fazave të projektimit të tij me qëllim garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

4. FAZAT E REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Fazat e projektimit për këtë objekt referuar *Vkm-së nr.354, datë 11.05.2016, Seksioni I, Neni 49* janë:

- Analiza e detyrës së projektimit/ termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit;
- Projektideja paraprake;
- Projektideja përfundimtare;
- Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit;
- Projekti i zbatimit;
- Preventivi përfundimtar;

A. ANALIZA E DETYRËS SË PROJEKTIMIT/ TERMAVE TË REFERENCËS DHE PËRCAKTIMI I BAZËS SË PROJEKTIT

Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës, për fushat specifike të strukturave mbajtëse. E rëndësishme në këtë fazë është konsultimi me inxhinierët dhe arkitektët e projektit

B. PROJEKT IDEA PARAPRAKE (PËRGATITJA E BAZAVE TË PROJEKTIT DHE PËRGATITJA PËR PROJEKTIM)

- Për projekte të veprave inxhinierike, siç përcaktohet në nenin 34, pika 6 dhe 7: ndërthurja e rezultateve sipas fazës I të shërbimit;
- Këshillim për çështje të projektimit të strukturës mbajtëse, duke marrë parasysh kërkesat mbi stabilitetin, funksionin dhe koston;
- Konsultë në pikëpamjen statiko-konstruktive duke patur parasysh problemet e qëndrueshmërisë, aftësisë për t'u përdorur dhe rentabilitetin ekonomik;
- Bashkëveprim për përpunimin e një koncepti planifikimi, përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme alternative të strukturës mbajtëse me kërkesa të njëjta të objektit me paraqitje vizatimore. Sqarimi dhe dhënia e përcaktimeve konstruktive kryesore për strukturën mbajtëse p.sh. për materialet e ndërtimit, mënyrat e ndërtimit dhe procedurat e prodhimit, rrjetat e konstruksionit dhe llojin e themelit-bazamentit;
- Negociatat paraprake me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me pajtueshmërinë dhe kushtet e miratimit;
- Ndihma në llogaritjen e koston paraprake edhe në rastin e ndërtesave dhe objekteve strukturore.

C. PROJEKT IDEA PËRFUNDIMTARE (SISTEMET DHE INTEGRIMI I TYRE NË PROJEKT)

- Zhvillimi i strukturës mbajtëse duke marrë parasysh planet e propozuara nga specialistët, si pjesë përbërëse për hartimin e projektit idesë përfundimtare, përfshirë këtu edhe paraqitjen grafike;
- Llogaritjet statike dhe matjet e përafërta;
- Përcaktime themelore të detajeve konstruktive dhe dimensioneve kryesore të strukturës mbajtëse për kompozimin e prerjeve tërthore mbajtëse, sipërfaqet e lira dhe lidhjet e mureve; zhvillimi i trarëve mbështetës të çatisë dhe pikave nyje si dhe e mjeteve lidhëse.
- Bashkëpunimi në përshkrimin e objektit;
- Bashkëpunimi në negociatat me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me kushtet e miratimit;
- Ndihma me llogaritjen e koston edhe në rastin e ndërtesave dhe impianteve strukturore;
- Ndihma gjatë kontrollit të koston duke krahasuar koston paraprake me koston e llogaritur

D. PROJEKTI PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT

- Përmbledhja e llogaritjeve statike të verifikueshme për konstruksionin mbajtës duke patur parasysh kërkesat e dhëna e përshkruara në ligjet dhe normat në fuqi;

- Veprat inxhinierike: Përshkrimi i kushteve normale të realizimit;
- Përgatitja e planeve të strukturave mbajtës, i planeve të kollonave, përcaktimi i llojit dhe cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe cilësitë e konstruksioneve të veçanta të dhëna në vizatimet e projektit të planifikuesit të objektit;
- Grumbullimi i dokumentave të planifikimit të strukturës mbajtëse për miratimin që shërben si bazë edhe për mbikëqyrjen e ndërtimit;
- Negocimi me qëndrat (struktura) e testimit dhe inxhinierë që merren me testimin e objektit;
- Plotësimi dhe rregullimi i llogaritjeve dhe planeve;
- Kompletimi dhe ndryshimi i llogaritjeve dhe vizatimeve.

E. PROJEKTI I ZBATIMIT

- Rishikimi/ripërpunimi i rezultateve të Fazës III-të dhe IV-ërt, të shërbimit duke repektuar integrimin e specialiteteve nëpërmjet planifikimit të objektit;
- Përgatitja e vizatimeve të betonformave/kallepëve si dhe të shtesave të projektit arkitekturor;
- Paraqitje vizatimore e konstruksioneve me udhëzime për vendosjen dhe zhvendosjen, p.sh. planet e përforcimeve (betonit), planet e ndërtimit me çelik, planet e konstruksioneve prej druri (jo vizatime të studios);
- Përpilimi i tabelave të hekurit ose profileve metalikë gjithashtu paraqitja e llogaritjeve të sasisë së tij.

F. PREVENTIVI PËRFUNDIMTAR

- Përcaktimi i sasisë së hekurit të armimit të nevojshëm për beton /armenë, sasinë e hekurit, dhe sasinë e drurit për teknikat e kornizave si një kontribut për llogaritjet e sasisë nga ana e projektuesit;
- Llogaritja e përafërt për sasinë e hekurit dhe lidhjet statikisht të nevojshme për ndërtimet me strukturë druri dhe mjeteve lidhëse dhe përforcuese të kërkuara nga ana statike në ndërtimet inxhinierike prej druri;
- Përcaktimet dhe specifikimet e projektit për të plotësuar llogaritjet sasiore si një bazë për preventivin për strukturën mbajtëse.

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar të gjitha fazat e mësipërme përfshirë dhe oponencën teknike të Institutit të Ndërtimit, sipas afateve përkatëse (përpara miratimit nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike).

5. RAPORTIMI DHE DORËZIMI FINAL

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje me ngjyra, në gjuhën shqipe. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg”. Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD) brenda një afati prej 2 muajsh nga lidhja e kontratës.